



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

**VENDIM**

**Nr. 583, Datë 17.01.2019**

**“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 8, neni 9, neni 24, shkronja (d) dhe neni 42 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE :**

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit, për periudhën kohore për vitet 2015-2018, dhe raporti i hetimit paraprak të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak janë kryer inspektime pranë Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), si dhe është kërkuar informacion në mënyrë shkresore nga FSHF-ja dhe Klubet e Futbollit.
3. Lidhur me kërkesën për informacion dërguar FSHF-së, fillimisht të dhënat e

depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës nuk ishin të plota dhe për këtë arsye me shkresën Nr. 631/4 Prot., datë 14.11.2018, i është kërkuar FSHF-së plotësimi i informacionit brenda datës 21.12.2018. FSHF-ja me shkresën Nr. 631/11 Prot., datë 28.12.2018, shprehet se do të dorëzojë informacionin e kërkuar brenda datës 15.01.2019, pasi kjo shkresë ka mbërritur në zyrat e saj në datën 28.12.2018. Nga FSHF informacioni është depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës më datë 16.01.2019, me shkresën Nr. 1486/1 Prot., datë 15.01.2019.

4. Koha e mbetur në dispozicion është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së FSHF-së, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 564, datë 25.10.2018.
5. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon Federata Shqiptare e Futbollit, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 564, datë 25.10.2018 “Për hapjen procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon”, pika “2”, të ndryshohet si vijon:  
*“2. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 25 Prill 2019.”.*
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**